

**RAPORT PËR PROCESIN E VERIFIKIMIT NGA SEKRETARI I PËRGJITHSHËM TË
PLOTËSIMIT TË KUSHTEVE LIGJORE DHE KRITEREVE PROFESIONALE E
MORALE PËR KANDIDATËT PËR KËSHILLIN E LARTË TË PROKURORISË NGA
TRUPA E PEDAGOGËVE**

**I. BAZA KUSHTETUESE DHE LIGJORE E PROCESIT TË VLERËSIMIT
NGA SEKRETARI I PËRGJITHSHËM**

Neni 149 i Kushtetutës, i cili parashikon ngritjen e Këshillit të Lartë të Prokurorisë, përcakton dhe detyrat e Sekretarit të Përgjithshëm në procesin e konstituimit të këtij Këshilli.

Referuar këtij neni:

“5. Sekretari i Përgjithshëm i Kuvendit, jo më vonë se 10 ditë nga paraqitja e kandidaturave, verifikon nëse kandidatët plotësojnë kushtet e parashikuara nga Kushtetuta dhe ligji, si dhe vlerëson kriteret profesionale e morale për anëtarin e Këshillit të Lartë të Prokurorisë dhe përgatit listën. Në rast se kandidatët nuk i plotësojnë kushtet dhe kriteret për t'u zgjedhur, Sekretari i Përgjithshëm i Kuvendit nuk i përfshin emrat e tyre në listë.

6. Sekretari i Përgjithshëm i Kuvendit pas përfundimit të verifikimeve, i dërgon menjëherë listën e kandidatëve që plotësojnë kriteret formale nënkomisionit, sipas paragrafit 7 të këtij neni.”

Detyrat e Sekretarit të Përgjithshëm në këtë proces janë detajuar në ligjin nr. 115/2016 “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”. Konkretisht në pikën 2 të nenit 151 “Përzgjedhja e anëtarit të Këshillit të Lartë të Prokurorisë nga trupa e pedagogëve të fakulteteve të Drejtësisë dhe Shkollës së Magjistraturës”, parashikohet se: *Rregullat e parashikuara në nenin 35, nga pika 2 deri në pikën 19, të këtij ligji, zbatohen edhe për përzgjedhjen e anëtarit të Këshillit të Lartë të Prokurorisë nga trupa e pedagogëve të fakulteteve të drejtësisë dhe Shkollës së Magjistraturës.*

Sa më sipër, në nenin 35 të këtij ligji, ndër të tjera parashikohet se:

“2. Sekretari i Përgjithshëm i Kuvendit, jo më vonë se 10 ditë nga dita e paraqitjes së listës dhe dokumentacionit shoqërues, të regjistruar sipas pikës 1, të këtij neni, verifikon, në bazë të dokumentacionit të paraqitur, nëse kandidatët plotësojnë kushtet e parashikuara nga Kushtetuta dhe neni 19 i këtij ligji. Sekretari i Përgjithshëm përjashton kandidatët, të cilët, sipas vlerësimit të tij, nuk i plotësojnë kushtet e parashikuara nga Kushtetuta dhe ky ligj.

3. Nëse dokumentacioni i kandidatit nuk është i plotë për të vlerësuar plotësimin e kushteve kushtetuese dhe ligjore, si dhe të kriterëve profesionale e morale, sipas nenit 19, pika 3, të këtij ligji, Sekretari i Përgjithshëm i kërkon kandidatit që brenda 5 ditëve të bëjë plotësimin e dokumentacionit ose paraqitjen e dokumenteve shtesë. Njoftimi për plotësimin e dokumentacionit

ose paraqitjen e dokumentacionit shtesë i dërgohet kandidatit në adresën elektronike të deklaruar.

4. Mosparaqitja e dokumentacionit plotësues ose dokumentacionit shtesë në përfundim të afatit 5-ditor, nuk pezullon procesin e regjistrimit përfundimtar në Kuvend të listës së kandidatëve dhe dokumentacionit shoqërues të saj.

5. Data në të cilën plotësohet dokumentacioni i kërkuar, ose afati i përcaktuar për plotësimin, konsiderohet dhe dita e paraqitjes dhe regjistrimit të listës së kandidatëve të dhe dokumentacionit shoqërues në Kuvend. Paraqitja përfundimtare dokumentohet me një numër regjistrimi nga zyra e protokollit në Kuvend.

6. Sekretari i Përgjithshëm vlerëson kriteret profesionale e morale vetëm për kandidatët të cilët plotësojnë kushtet e parashikuara nga Kushtetuta dhe ky ligj për të qenë anëtarë të Këshillit të Lartë Gjyqësor. Vlerësimi i kriterëve profesionale e morale të kandidatëve nga Sekretari i Përgjithshëm bëhet sipas kriterëve të parashikuara në nenin 34 të këtij ligji.

7. Sekretari i Përgjithshëm, në përfundim të procedurës së parashikuar në pikat 2 dhe 6, të këtij neni, harton dokumentet e mëposhtme:

a) një listë me emrat e kandidatëve që plotësojnë kushtet e parashikuara nga Kushtetuta dhe ky ligj për të qenë anëtarë të Këshillit të Lartë Gjyqësor;

b) një listë me emrat e kandidatëve, të cilët, sipas vlerësimit të tij, nuk i plotësojnë kushtet e parashikuara nga Kushtetuta dhe ky ligj për të qenë anëtarë të Këshillit të Lartë Gjyqësor. Lista e kandidatëve të përjashtuar përmban emrat e tyre dhe arsyet e përjashtimit për secilin;

c) një raport me shkrim, ku vlerësohet shkalla e përmbushjes së kriterëve profesionale e morale nga secili kandidat, mbështetur në procesin e zhvilluar dhe raportin e përgatitur nga Komisioni i Pavarur Ad Hoc.

8. Kandidatët e përjashtuar njoftohen me shkrim, në mënyrë individuale dhe të arsyetuar për përjashtimin në adresën e tyre elektronike të deklaruar.

9. Sekretari i Përgjithshëm i dërgon komisionit të përhershëm përgjegjës për çështjet ligjore në Kuvend, brenda ditës së nesërme nga dita e hartimit të dokumenteve të parashikuara në pikën 7, të këtij neni, listat, së bashku me raportin e parashikuar në pikën 7, shkronja "c", të këtij neni, si dhe dokumentacionin për secilin kandidat. Listat dhe raporti bëhen publikë në faqen zyrtare të Kuvendit jo më vonë se 10 ditë pas regjistrimit të listës së kandidatëve në Kuvend.

10. Në zbatimin e detyrave të parashikuara në pikat 1 deri në 6, të këtij neni, Sekretari i Përgjithshëm mbështetet nga shërbimet e Kuvendit.

Vlerësimi dhe verifikimi i Sekretarit të Përgjithshëm të Kuvendit fillon menjëherë pas depozitimit në Kuvend të dokumentacionit dhe të listës së kandidatëve për KLP nga trupa e pedagogëve, nga Mbledhja e Posaçme e Drejtuesve të Institucioneve të Arsimit të Lartë dhe Shkollës së Magjistraturës.

II. PROCESI I VERIFIKIMIT NGA SEKRETARI I PËRGJITHSHËM TË PLOTËSIMIT TË KUSHTEVE LIGJORE SIPAS NENIT 134 DHE 287 TË LIGJIT NR. 115/2016 “PËR ORGANET E QEVERISJES SË SISTEMIT TË DREJTËSISË”

A. Procesi i aplikimit të kandidatëve për anëtarë të KLP nga trupa e pedagogëve

Në datën 13.01.2017, Kuvendi i Shqipërisë shpalli në faqen zyrtare të tij vendet vakante për dy anëtarë të Këshillit të Lartë të Prokurorisë nga trupa e pedagogëve të Fakulteteve të Drejtësisë dhe të Shkollës së Magjistraturës.

Në vijim të kësaj shpalljeje, institucionet e ngarkuara nga ligji vijuan me procedurat përkatëse të përcaktuara nga nenet 134-146 të ligjit nr.115/2016 “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”.

Në përfundim të procesit të aplikimeve, të verifikimit dhe të votimit, për anëtarë të Këshillit të Lartë të Prokurorisë, nga asambltetë e personelit akademik të fakulteteve të drejtësisë dhe të Këshillit Pedagogjik të Shkollës së Magjistraturës, , gjatë muajit shkurt 2017 u depozituan pranë protokollit të Kuvendit kërkesat si dhe një kopje e dokumentacionit të kandidatëve.

Në përfundim të këtij procesi u konstatua se numri total i kandidaturave të paraqitura për KLP-në, ishte më i vogël se numri minimal i kandidaturave që kërkohen nga neni 151 i ligjit nr. 115/2016 për t’u paraqitur Sekretarit të Përgjithshëm të Kuvendit nga Mbledhja e Posaçme, sipas të cilit duhet të ketë jo më shumë se 10 kandidatë dhe në çdo rast jo më pak se trefishi i numrit të vendeve vakante (jo më pak se 6).

Për këtë arsye, Sekretari i Përgjithshëm vendosi t’u kërkojë Institucioneve të Arsimit të Lartë, rishpalljen e thirrjeve për paraqitjen e shprehjeve të interesit nga radhët e personelit akademik për anëtarë të KLP-së.

Numri minimal i kandidaturave u plotësua vetëm pas rishpalljes për herë të tretë të thirrjeve për shprehje interesi nga trupa e pedagogëve. Menjëherë pas plotësimit të këtij numri, Sekretari i Përgjithshëm i Kuvendit me vendimin nr. 9, datë 05.09.2017, vendosi thirrjen e Mbledhjes së Posaçme të Drejtuesve të IAL-ve dhe Shkollës së Magjistraturës për përzgjedhjen e kandidatëve për Këshillin e Lartë të Prokurorisë, në përputhje me parashikimet e nenit 146 të ligjit nr. 115/2016.

I gjithë procesi i organizimit të Mbledhjes së Posaçme, u mbështet nga Sekretariati Teknik i administratës së Kuvendit, i ngritur me urdhër të Sekretarit të Përgjithshëm të Kuvendit. Sekretari i Përgjithshëm mori masat e nevojshme logjistike dhe organizative, përfshirë pajisjet e nevojshme për realizimin e procesit të votimit dhe dëgjësës së kandidatëve për thirrjen e Mbledhjes së Posaçme.

Gjithashtu, në përmbushje të kërkesave ligjore të parashikuara nga neni 148, pika 6, i ligjit nr. 115/2016, u ftuan të mermin pjesë në Mbledhjen e Posaçme, në cilësinë e vëzhguesve, ministri i Drejtësisë si dhe dy deputetë, anëtarë të Komisionit parlamentar përgjegjës për çështjet ligjore.

Në kuadër të transparencës, Mbledhja e Posaçme u organizua e hapur, me prezencën e medias, me regjistrim audio-video, si dhe me praninë e përfaqësuesve të organizmave ndërkombëtarë (EURALIUS, USAID), të shoqërisë civile (Komiteti Shqiptar i Helsinkit), etj.

Në përfundim të procesit të votimit Mbledhja e Posaçme votoi 7 kandidatura për anëtarë të Këshillit të Lartë të Prokurorisë.

B. Procedura e ndjekur nga Sekretari i Përgjithshëm i Kuvendit pas paraqitjes së dosjeve të kandidatëve për KLP, që përfaqëson Trupën e Pedagogëve nga Mbledhja e Posaçme e Drejtuesve të Institucioneve të Arsimit të Lartë Publik dhe Privat dhe Shkolla e Magjistraturës.

Në mbështetje të nenit 151, pika 1 dhe nenit 35 të ligjit nr. 115/2016 “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”, me shkresën nr. 2014/22 Prot., datë 03.10.2017, Mbledhja e Posaçme e Drejtuesve të Institucioneve të Arsimit të Lartë dhe Shkollës së Magjistraturës ka përcjellë pranë Sekretarit të Përgjithshëm të Kuvendit të Shqipërisë, listën e 7 (shtatë) kandidatëve të votuar nga kjo Mbledhje si kandidatë për anëtarë të Këshillit të Lartë të Prokurorisë. Gjithashtu, për çdo kandidat është përcjellë dosja përkatëse së bashku me procesverbalin e votimit, rezultatin e votimit dhe raportin e mbledhje ë asambleve të personelit akademik të IAL-ve dhe të Këshillit Pedagogjik të Shkollës së Magjistraturës, të administruara nga IAL-të përkatëse ose Shkolla e Magjistraturës.

Sekretari i Përgjithshëm i Kuvendit të Shqipërisë, në zbatim të nenit 151, pika 2 dhe nenit 35 të ligjit nr. 115/2016 “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”, pas depozitimit të listës së kandidatëve nga trupa e pedagogëve për anëtarë të KLGJ-së dhe të dosjeve përkatëse, ka filluar menjëherë punën për verifikimin e plotësisë së kushteve ligjore të kandidatëve, bazuar në

parashikimet e Kushtetutës dhe nenit 134 të ligjit nr. 115/2016 “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”.

Njëkohësisht, në mbështetje të nenit 287, pika 2, të ligjit nr. 115/2016 Sekretari i Përgjithshëm i Kuvendit të Shqipërisë, në datë 03.10.2017, i ka përcjellë Operacionit Ndërkombëtar të Monitorimit kopje të dokumentacionit të depozituar nga Mbledhja e Posaçme e Drejtuesve të Institucioneve të Arsimit të Lartë dhe Shkollës së Magjistraturës dhe të administruar për çdo kandidat në Kuvendin e Shqipërisë (shkresa nr.2014/24, datë 03.10.2017).

Njëkohësisht me kërkesën për plotësimin e dokumentacionit, Sekretari i Përgjithshëm i Kuvendit, në përmbushje të detyrimeve ligjore të përcaktuara në pikën 2 të nenit 35 të ligjit nr. 115/2016, ka vijuar me procesin e shqyrtimit dhe vlerësimit të dokumentacionit të ndodhur në dosjen personale të secilit kandidat.

Bazuar në pikat 3 dhe 4 të nenit 35 të ligjit, Sekretari i Përgjithshëm, gjatë verifikimit të plotësimit të kushteve të parashikuara nga Kushtetuta dhe nga neni 134 i ligjit nr. 115/2016, ka konstatuar se disa kandidatë, të cilët sipas verifikimit të mbledhjeve të asamblesë së personelit akademik janë vlerësuar se plotësojnë kushtet kushtetuese dhe ligjore, kishin mangësi në dokumentacionin ligjor, që provon plotësimin e këtyre kushteve.

Për sa më sipër, Sekretari i Përgjithshëm, bazuar në parashikimet e pikës 3 të nenit 35 të ligjit nr. 115/2016, u ka komunikuar këtyre kandidatëve në datat 10.10.2017, përmes postës elektronike personale të deklaruar në momentin dhe dokumentacionin e aplikimit, mangësitë që kanë në dosje, duke vendosur një afat 5-ditor në përputhje me afatin ligjor për plotësimin e dokumentacionit të kërkuar.

Në përgjigje të kërkesës së Kuvendit, vetë kandidatët në mënyrë individuale, brenda afatit 5-ditor, kanë plotësuar dosjet individuale me dokumentacionin e kërkuar.

Në përmbushje të këtij procesi, Sekretari i Përgjithshëm i Kuvendit të Shqipërisë, në zbatim të kompetencave të tij, bazuar në parashikimet e ligjit nr. 115/2016 “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”, në kushtet kur ndodhet në fazën e verifikimit të plotësimit të kushteve ligjore për të gjithë kandidatët që kanë aplikuar nga trupa e pedagogëve, ka kërkuar kryerjen e verifikimeve përkatëse pranë institucioneve ligjzbatuese:

- Prokuroria e Përgjithshme;
 - Autoriteti për Informimin mbi Dokumentet e Ish-Sigurimit të Shtetit;
 - Inspektorati i Lartë i Kontrollit dhe Deklarimit të Pasurive dhe Konfliktit të Interesave;
- dhe

- Drejtoria e Përgjithshme e Burgjeve.

Konkretisht, nëpërmjet shkresës nr.2014/27, datë 10.10.2017, Sekretari i Përgjithshëm i Kuvendit ka kërkuar pranë Autoritetit për Informimin mbi Dokumentet e Ish-Sigurimit të Shtetit, në zbatim të detyrimeve që rrjedhin nga ligji nr. 45/2015 “Për të drejtën e informimit për dokumentet e ish-Sigurimit të Shtetit të Republikës Popullore Socialiste të Shqipërisë”, verifikimin e plotësisë nga kandidatët të kushtit ligjor të parashikuar nga neni 134, pika 2, germa “f” të ligjit nr. 115/2016, sipas të cilit kandidatët nuk duhet të kenë qenë anëtarë, bashkëpunëtorë ose të favorizuar të Ish-Sigurimit të Shtetit përpara 2 Korrikut 1991.

Autoriteti për Informimin mbi Dokumentet e Ish-Sigurimit të Shtetit, me shkresën nr. 500/4, datë 30.10.2017, informon se në mbështetje të vendimit nr. 65, datë 27.10.2017, nga verifikimet e deritanishme, nuk figurojnë të ketë materiale të krijuara nga ish - Sigurimi i Shtetit për kandidatët nga trupa e pedagogëve për Këshillin e Lartë të Prokurorisë.

- Në vijim të kërkesës për informacion të dërguar nga Sekretari i Përgjithshëm i Kuvendit, nëpërmjet shkresës nr.2014/26, datë 10.10.2017, Inspektorati i Lartë i Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive dhe Konfliktit të Interesave, shprehet se vetëm tre nga kandidatët për anëtarë të KLP-së dhe KLGJ-së nga trupa e pedagogëve, kanë qenë subjekte deklaruese pranë ILDKPKI-së dhe për këta tre kandidatë, nuk ka pasur probleme në deklarimin e interesave të tyre private.
- Për të verifikuar integritetin e kandidaturave, Sekretari i Përgjithshëm i është drejtuar Prokurorisë së Përgjithshme me shkresat nr. 2014/25, datë 10.10.2017, duke i përcjellë formularët e deklarimit të plotësuar nga secili nga shtatë kandidatët, sipas kërkesave të ligjit nr. 138/2015 “Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen, dhe ushtrojnë funksione publike”, i ndryshuar, për të kthyer përgjigjen në respektim të afateve ligjore. Nëpërmjet shkresës nr. 2612/5, datë 18.10.2017, Prokuroria e Përgjithshme informon se pas verifikimeve të subjekteve deklaruese rezultoi se asnjë prej 7 kandidatëve për anëtarë të Këshillit të Lartë të Prokurorisë nuk përfshihet në fushën e veprimit të nenit 2 të ligjit nr. 138/2015 “Për garantimin e integritetit të personave që përzgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike”.
- Për të verifikuar gjendjen gjyqësore të kandidatëve të cilët në dosjet personale kishin depozituar vetëm formularin e vetëdeklarimit të gjendjes gjyqësore, Sekretari i Përgjithshëm, me shkresën nr. 2457/7, datë 13.10.2017, ka kërkuar nga Drejtoria e Përgjithshme e Burgjeve, verifikimin e gjendjes gjyqësore për këta kandidatë. Drejtoria e

Përgjithshme e Burgjeve, me shkresën nr. 4311, datë 23.10.2017, konfirmon se të katër kandidatët rezultojnë të padënuar.

Për të gjithë procedurën e ndjekur, Kuvendi i Shqipërisë me shkresën nr.2457/17 prot, datë 17.10.2017 dhe në rrugë elektronike, ka informuar Operacionin Ndërkombëtar të Monitorimit, duke paraqitur njëkohësisht edhe kopje të dokumenteve plotësuese të dorëzuara nga kandidatët.

III. VERIFIKIMI I PLOTËSIMIT TË KUSHTEVE LIGJORE NGA KANDIDATËT

Sekretari i Përgjithshëm i Kuvendit, bazuar në pikat 2 dhe 3 të nenit 35 të ligjit nr. 115/2016 “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”, parashtruar më lart:

- ka verifikuar nëse dokumentacioni i kandidatëve është i plotë, duke kërkuar nga kandidatët plotësimet përkatëse;
- ka verifikuar dhe vlerësuar plotësimin e kushteve të parashikuara nga neni 149 i Kushtetutës dhe neni 134, pika 2 i ligjit nr. 115/2016 si dhe të dokumentacionit, që shoqëron shprehjen e interesit, të parashikuar në pikën 3 të nenit 137 të po këtij ligji.

Pas njoftimit për plotësimin e dokumentacionit apo paraqitjen e dokumentacionit shtesë, në adresën elektronike të deklaruar nga kandidatët, si dhe pas përgjigjeve të institucioneve publike të cilave iu drejtua me shkresë zyrtare për verifikim të kushteve ligjore, Sekretari i Përgjithshëm i Kuvendit konstaton në vijim:

A. KANDIDATËT QË PLOTËSOJNË KUSHTET LIGJORE

- Plotësimi i dokumentacionit, si dhe verifikimi e vlerësimi i plotësimit të kushteve ligjore për çdo kandidat është si më poshtë:

1. Kandidatja Mirela Bogdani

Nga shqyrtimi i dosjes së kandidates ka rezultuar se mungonte kopje e noterizuar e pasaportës/kartës së identitetit.

Në përgjigje të shkresës nr.2014/29, datë 10.10.2017 të Sekretarit të Përgjithshëm, për plotësimin dhe dërgimin e dokumentacionit, kandidatja ka paraqitur dokumentet e kërkuara brenda afatit ligjor 5 ditor për plotësimin e dokumentacionit.

Në vazhdim të verifikimit të dokumentacionit të paraqitur, sipas kushteve ligjore të renditura në pikën 2 të nenit 134 të ligjit nr. 115/2016, rezulton se kandidatja Mirela Bogdani:

- a) është shtetase shqiptare;
- b) ka jo më pak se 15 vjet përvojë pune në profesion si juriste, sipas librezës së punës së paraqitur;
- c) në kohën e kandidimit, rezulton të jetë pedagoge me kohë të plotë në Fakultetin e Drejtësisë, Universiteti i Tiranës, jo më pak se 5 vjet (prej vitit 2000 e në vazhdim);
- ç) është personel akademik i kategorisë "profesor";
- d) në kohën e kandidimit nuk rezulton të jetë rektor ose Drejtor i Shkollës së Magjistraturës;
- dh) rezulton se nuk ka masë disiplinore në fuqi;
- e) nuk është dënuar me vendim gjyqësor të formës së prerë për kryerjen e një vepre penale;
- ë) nuk ka mbajtur gjatë 10 viteve të fundit funksione politike në administratën publike ose pozicione drejtuese në partitë politike përpara kandidimit;
- f) nuk ka qenë anëtare, bashkëpunëtore ose e favorizuar e ish-Sigurimit të Shtetit para 2 korrikut 1991 në kuptimin e ligjit "Për të drejtën e informimit për dokumentet e ish-Sigurimit të Shtetit të Republikës Popullore Socialiste të Shqipërisë";
- g) nuk rezulton të ketë qenë bashkëpunëtore, informatore ose agjente e shërbimeve inteligjente;
- gj) në kohën e kandidimit, nuk rezulton të ketë asnjë anëtar të familjes, sipas kuptimit të ligjit "Për deklarimin dhe kontrollin e pasurive, të detyrimeve financiare të të zgjedhurve dhe të disa nëpunësve publikë", si dhe të afërm të shkallës së parë që është kandidat për në Këshill.

2. Kandidatja Oriona Muçollari

Nga shqyrtimi i dosjes së kandidatës ka rezultuar se mungonte dokumentacioni që vërteton se nuk është dënuar me vendim gjyqësor të formës së prerë për kryerjen e një vepre penale, si dhe lista e notave, kopje e njëzuar me origjinalin.

Në përgjigje të shkresës nr.2014/32, datë 10.10.2017 të Sekretarit të Përgjithshëm, për plotësimin dhe dërgimin e dokumentacionit, kandidatja ka paraqitur dokumentet e kërkuara brenda afatit ligjor 5 ditor për plotësimin e dokumentacionit.

Në vazhdim të verifikimit të dokumentacionit të paraqitur, sipas kushteve ligjore të renditura në pikën 2 të nenit 134 të ligjit nr. 115/2016, rezulton se kandidatja Oriona Muçollari:

- a) është shtetase shqiptare;

- b) ka jo më pak se 15 vjet përvojë pune në profesion si juriste, sipas librezës së punës së paraqitur;*
- c) në kohën e kandidimit, rezulton të jetë pedagoge me kohë të plotë në Fakultetin e Drejtësisë, Universiteti i Tiranës, jo më pak se 5 vjet (prej vitit 2005);*
- ç) është personel akademik i kategorisë “profesor”;*
- d) në kohën e kandidimit nuk rezulton të jetë rektor ose Drejtor i Shkollës së Magjistraturës;*
- dh) rezulton se nuk ka masë disiplinore në fuqi;*
- e) nuk është dënuar me vendim gjyqësor të formës së prerë për kryerjen e një veprë penale;*
- ë) nuk ka mbajtur gjatë 10 viteve të fundit funksione politike në administratën publike ose pozicione drejtuese në partitë politike përpara kandidimit;*
- f) nuk ka qenë anëtare, bashkëpunëtoare ose e favorizuar e ish-Sigurimit të Shtetit para 2 korrikut 1991 në kuptimin e ligjit “Për të drejtën e informimit për dokumentet e ish-Sigurimit të Shtetit të Republikës Popullore Socialiste të Shqipërisë”;*
- g) nuk rezulton të ketë qenë bashkëpunëtoare, informatore ose agjente e shërbimeve inteligjente;*
- gj) në kohën e kandidimit, nuk rezulton të ketë asnjë anëtar të familjes, sipas kuptimit të ligjit “Për deklarimin dhe kontrollin e pasurive, të detyrimeve financiare të të zgjedhurve dhe të disa nëpunësve publikë”, si dhe të afërm të shkallës së parë që është kandidat për në Këshill.*

3. Kandidatja Eneida Sema

Nga shqyrtimi i dosjes së kandidatës ka rezultuar se mungonte kopje e njëzuar me origjinalin e diplomës, dëshmisë së gjuhëve të huaja si dhe listës së notave.

Në përgjigje të shkresës nr.2014/28, datë 10.10.2017 të Sekretarit të Përgjithshëm, për plotësimin dhe dërgimin e dokumentacionit, kandidatja ka paraqitur dokumentet e kërkuara brenda afatit ligjor 5 ditor për plotësimin e dokumentacionit.

Në vazhdim të verifikimit të dokumentacionit të paraqitur, sipas kushteve ligjore të renditura në pikën 2 të nenit 134 të ligjit nr. 115/2016, rezulton se kandidatja Eneida Sema:

- a) është shtetase shqiptare;*
- b) ka jo më pak se 15 vjet përvojë pune në profesion si juriste, sipas librezës së punës së paraqitur;*
- c) në kohën e kandidimit, rezulton të jetë pedagoge me kohë të plotë në Fakultetin e Drejtësisë, Universiteti i Tiranës, jo më pak se 5 vjet (prej vitit 2004);*
- ç) është personel akademik i kategorisë “profesor”;*
- d) në kohën e kandidimit nuk rezulton të jetë rektor ose Drejtor i Shkollës së Magjistraturës;*
- dh) rezulton se nuk ka masë disiplinore në fuqi;*

- e) nuk është dënuar me vendim gjyqësor të formës së prerë për kryerjen e një vepre penale;
- ë) nuk ka mbajtur gjatë 10 viteve të fundit funksione politike në administratën publike ose pozicione drejtuese në partitë politike përpara kandidimit;
- f) nuk ka qenë anëtare, bashkëpunëtore ose e favorizuar e ish-Sigurimit të Shtetit para 2 korrikut 1991 në kuptimin e ligjit “Për të drejtën e informimit për dokumentet e ish-Sigurimit të Shtetit të Republikës Popullore Socialiste të Shqipërisë”;
- g) nuk rezulton të ketë qenë bashkëpunëtore, informatore ose agjente e shërbimeve inteligjente;
- gj) në kohën e kandidimit, nuk rezulton të ketë asnjë anëtar të familjes, sipas kuptimit të ligjit “Për deklarimin dhe kontrollin e pasurive, të detyrimeve financiare të të zgjedhurve dhe të disa nëpunësve publikë”, si dhe të afërm të shkallës së parë që është kandidat për në Këshill.

4. Kandidati Sandër Beci

Nga shqyrtimi i dosjes së kandidatit ka rezultuar se mungonte dokumentacioni si më poshtë:

- a.vetëdeklarimi se nuk ka mbajtur gjatë 10 viteve të fundit funksione politike në administratën publike ose pozicione drejtuese në partitë politike përpara kandidimit;
- b.vetëdeklarimi se në kohën e kandidimit nuk ka asnjë anëtar të familjes sipas kuptimit të ligjit “Për deklarimin dhe kontrollin e pasurive, të detyrimeve financiare të të zgjedhurve dhe të disa nëpunësve publikë”, si dhe të afërm të shkallës së parë që është kandidat për anëtar i Këshillit;
- c.dëshmia e gjuhës së huaj e njësuar me origjinalin.

Në përgjigje të shkresës nr.2014/34, datë 10.10.2017 të Sekretarit të Përgjithshëm, për plotësimin dhe dërgimin e dokumentacionit, kandidati ka paraqitur dokumentet e kërkuara brenda afatit ligjor 5 ditor për plotësimin e dokumentacionit.

Në vazhdim të verifikimit të dokumentacionit të paraqitur nga kandidati, sipas kushteve ligjore të renditura në pikën 2 të nenit 134 të ligjit nr. 115/2016, rezulton se kandidati Sandër Beci:

- a) është shtetas shqiptar;
- b) ka jo më pak se 15 vjet përvojë pune në profesion si jurist,;
- c) në kohën e kandidimit, rezulton të jetë pedagog me kohë të plotë në Fakultetin e Drejtësisë, Universiteti “Luigj Gurakuqi”, jo më pak se 5 vjet (prej vitit 1996);
- ç) është personel akademik i kategorisë “lektor”;
- d) në kohën e kandidimit nuk rezulton të jetë rektor ose Drejtor i Shkollës së Magjistraturës;
- dh) rezulton se nuk ka masë disiplinore në fuqi;
- e) nuk është dënuar me vendim gjyqësor të formës së prerë për kryerjen e një vepre penale;
- ë) nuk ka mbajtur gjatë 10 viteve të fundit funksione politike në administratën publike ose pozicione drejtuese në partitë politike përpara kandidimit;

f) nuk ka qenë anëtar, bashkëpunëtor ose i favorizuar i ish-Sigurimit të Shtetit para 2 korrikut 1991 në kuptimin e ligjit "Për të drejtën e informimit për dokumentet e ish-Sigurimit të Shtetit të Republikës Popullore Socialiste të Shqipërisë";

g) nuk rezulton të ketë qenë bashkëpunëtor, informator ose agjent i shërbimeve inteligjente;

gj) në kohën e kandidimit, nuk rezulton të ketë asnjë anëtar të familjes, sipas kuptimit të ligjit "Për deklarimin dhe kontrollin e pasurive, të detyrimeve financiare të të zgjedhurve dhe të disa nëpunësve publikë", si dhe të afërm të shkallës së parë që është kandidat për në Këshill.

5. Kandidati Gent Ibrahim

Nga shqyrtimi i dosjes së kandidatit ka rezultuar se mungonte dokumentacioni që vërteton se nuk ka masë disiplinore në fuqi, si dhe vetëdeklarimi se në kohën e kandidimit nuk ka asnjë anëtar të familjes sipas kuptimit të ligjit "Për deklarimin dhe kontrollin e pasurive, të detyrimeve financiare të të zgjedhurve dhe të disa nëpunësve publikë" si dhe të afërm të shkallës së parë që është kandidat për anëtar i Këshillit.

Në përgjigje të shkresës nr.2014/36, datë 10.10.2017 të Sekretarit të Përgjithshëm, për plotësimin dhe dërgimin e dokumentacionit, kandidati ka paraqitur dokumentet e kërkuara brenda afatit ligjor 5 ditor për plotësimin e dokumentacionit.

Në vazhdim të verifikimit të dokumentacionit të paraqitur nga kandidati, sipas kushteve ligjore të renditura në pikën 2 të nenit 134 të ligjit nr. 115/2016, rezulton se kandidati Gent Ibrahim:

a) është shtetas shqiptar;

b) ka jo më pak se 15 vjet përvojë pune në profesion si jurist;

c) në kohën e kandidimit, rezulton të jetë pedagog i jashtëm, jomagjistratë, në Shkollën e Magjistraturës prej vitit 2003);

Lidhur me kushtin e parashikuar në shkronjën c), referuar dokumentacionit që ndodhet i administruar në dosje, rezulton e vërtetuar se kandidati ka qenë i përfshirë në procesin e mësimdhënës në Shkollën e Magjistraturës, nga viti 2003 e në vijim, si pedagog i jashtëm në Programin e Trajnimit Fillestar dhe si Trajner/Ekspert në Programin e Trajnimit Vazhdues. Për vetë specifikën që ka Shkolla e Magjistraturës, individët që kryejnë të dy këto funksione të mësimdhënies (pedagog i jashtëm dhe trajner/ekspert), sipas Rregullores së miratuar nga Këshilli Drejtues i Shkollës së Magjistraturës (Aneksi 11), konsiderohen/përkufizohen si pjesë e stafit pedagogjik të Programit të Formimit Fillestar dhe të Formimit Vazhdues dhe si të tillë nuk kanë asnjë dallim, në kriteret për

përzgjedhjen, procedurën që ndiqet, organin emërtesë që i miraton, të drejtat dhe detyrimet, si dhe në shkaqet për largim.

Për sa më sipër, në kuptim të ushtrimit të detyrës përkatëse në Shkollën e Magjistraturës, vlerësoj se kandidati plotëson kushtet ligjore, sipas nenit 264 të ligjit nr. 115/2016, si dhe të Rregullores së Shkollës, që përcaktojnë kriteret që kërkohen për të qenë pedagog në Programin e Trajnimit Fillestar, ose trajner/ekspert në Programin e Trajnimit Vazhdues, për të cilat nuk është kusht pasja e gradës apo titullit shkencor.

Ky konkluzion bazohet edhe në faktin se mënyra e organizimit dhe mësimdhënia në Shkollën e Magjistraturës nuk parashikohen në ligjin nr. 80/2015 “Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë”, por në ligjin nr. 115/2016 dhe në ligjin nr. 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, që ndër të tjera janë ligje të miratuara me shumicë të cilësuar prej 3/5 dhe si të tilla kanë përparësi nga pikëpamja e hierarkisë normative.

Ligji nr. 115/2016 (neni 134, pika 8) ka bërë një dallim të qartë ndërmjet “anëtarëve të personelit akademik” të IAL-ve, që sipas ligjit “Për arsimin e Lartë”, duhet të jenë “lektorë” ose “profesorë”, si dhe “pedagogëve jo magjistratë të Shkollës së Magjistraturës”. Duke qenë se për pedagogët e Shkollës së Magjistraturës nuk veprojnë rregullimet e ligjit “Për arsimin e lartë”, por rregullat e ligjit specifik nr.115/2016, edhe kriteret për ta janë të lidhura me eksperiencën profesionale në sistemin e drejtësisë ose në mësimdhënie, si dhe me aftësitë në punë (neni 264 i ligjit nr. 115/2016).

Dallimi ndërmjet personelit akademik të fakulteteve të drejtësisë së IAL-ve dhe pedagogëve të Shkollës së Magjistraturës konfirmohet edhe nga parashikimet e nenit 134, paragrafi 2, shkronja “c” të ligjit nr. 115/2016, “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”, ku për të parët kërkohet si kusht që “kandidatët të jenë pedagoge me kohë të plotë, jo më pak se 5 vjet në fakultetin e drejtësisë të IAL-ve, ndërsa për të dytët të jenë “pedagogë të brendshëm ose të jashtëm jo magjistratë në Shkollën e Magjistraturës”.

I njëjti interpretim është bërë edhe nga vetë Këshilli Pedagogjik i Shkollës së Magjistraturës gjatë verifikimit të plotësimit të kushteve ligjore nga kandidati. Përderisa kandidati vjen nga radhët e pedagogëve të Shkollës së Magjistraturës, kategorizimi “lektor” dhe “profesor”, i parashikuar në ligjin nr. 80/2015 “Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë”, është i zbatueshëm vetëm për personelin akademik që vjen nga radhët e IAL-ve dhe nuk zbatohet për pedagogët e Shkollës së Magjistraturës, që në pjesën më të madhe vijnë nga praktika profesionale dhe ndaj të cilëve aplikohen dispozitat përkatëse të ligjit nr. 115/2016, që rregullojnë mënyrën e organizimit të Shkollës së Magjistraturës, si dhe aktet nënligjore (Rregullorja) të miratuara në zbatim të këtyre dispozitave nga Këshilli Drejtues i Shkollës së Magjistraturës.

- d) në kohën e kandidimit nuk rezulton të jetë rektor ose Drejtor i Shkollës së Magjistraturës;
- dh) rezulton se nuk ka masë disiplinore në fuqi;
- e) nuk është dënuar me vendim gjyqësor të formës së prerë për kryerjen e një vepre penale;
- ë) nuk ka mbajtur gjatë 10 viteve të fundit funksione politike në administratën publike ose pozicione drejtuese në partitë politike përpara kandidimit;
- f) nuk ka qenë anëtar, bashkëpunëtor ose i favorizuar i ish-Sigurimit të Shtetit para 2 korrikut 1991 në kuptimin e ligjit "Për të drejtën e informimit për dokumentet e ish-Sigurimit të Shtetit të Republikës Popullore Socialiste të Shqipërisë";
- g) nuk rezulton të ketë qenë bashkëpunëtor, informator ose agjent i shërbimeve inteligjente;
- gj) në kohën e kandidimit, nuk rezulton të ketë asnjë anëtar të familjes, sipas kuptimit të ligjit "Për deklarimin dhe kontrollin e pasurive, të detyrimeve financiare të të zgjedhurve dhe të disa nëpunësve publikë", si dhe të afërm të shkallës së parë që është kandidat për në Këshill.

Për rrjedhojë, në vijim të argumenteve të parashtruara më sipër, Sekretari i Përgjithshëm i Kuvendit vlerëson se kandidati Gent Ibrahim plotëson kushtet ligjore, sipas nenit 134, pika 2, të ligjit nr. 115/2016, për të qenë anëtar i Këshillit të Lartë të Prokurorisë.

B. KANDIDATËT QË NUK PLOTËSOJNË KUSHTET LIGJORE

1. Kandidati Darjel Sina

Nga shqyrtimi i dosjes së kandidatit ka rezultuar se mungonte:

- a. dokumentacioni që vërtetonte 15 vjet eksperiencë pune si jurist;
- b. vërtetim që nuk ka masë disiplinore në fuqi, sipas germës "dh", të pikës 2 të nenit 134 të ligjit nr. 115/2016;
- c. dokumentacioni që vërteton se nuk është dënuar me vendim gjyqësor të formës së prerë për kryerjen e një vepre penale, sipas germës "e" të pikës 2 të nenit 134 të ligjit nr. 115/2016;
- d. vetëdeklarimi nën përgjegjësinë e kandidatit, se nuk ka mbajtur gjatë 10 viteve të fundit funksione politike në administratën publike ose pozicione drejtuese në partitë politike përpara kandidimit, sipas germës "ë" të pikës 2 të nenit 134 të ligjit nr. 115/2016;
- e. vetëdeklarimi nën përgjegjësinë e kandidatit se në kohën e kandidimit nuk ka asnjë anëtar të familjes sipas kuptimit të ligjit "Për deklarimin dhe kontrollin e pasurive, të detyrimeve financiare të të zgjedhurve dhe të disa nëpunësve publikë" si dhe të afërm të shkallës së parë që është anëtar në detyrë i Këshillit ose kandidat për anëtar, sipas germës "gj" të pikës 2 të nenit 134 të ligjit nr. 115/2016;

- f. formularët e mbështetjes së edhe nga dy anëtarë të personelit akademik;
- g. kopje e njësuar me origjinalin e pasaportës apo kartës të identitetit;
- h. dëshmitë titujve shkencorë duhet të paraqiten të njësuar me origjinalin.

Në përgjigje të shkresës nr.2014/31, datë 10.10.2017 të Sekretarit të Përgjithshëm, për plotësimin dhe dërgimin e dokumentacionit, kandidati ka paraqitur dokumentet e kërkuara brenda afatit ligjor 5 ditor për plotësimin e dokumentacionit.

Në vazhdim të verifikimit të dokumentacionit të paraqitur nga kandidati, sipas kushteve ligjore të renditura në pikën 2 të nenit 134 të ligjit nr. 115/2016, rezulton se kandidati Darjel Sina:

- a) është shtetas shqiptar;
- b) nuk rezulton të ketë 15 vjet përvojë pune në profesion si jurist, për arsye se është diplomuar në datë 3.2.2004, pranë Universitetit të Athinës, fakt i cili vërtetohet edhe nga njësimi i diplomës së bërë nga Ministria e Arsimit dhe Shkencës;
- c) në kohën e kandidimit, rezulton të jetë pedagog me kohë të plotë në disa fakultete drejtësie, jo më pak se 5 vjet (prej vitit 2009 e në vijim);
- ç) është personel akademik i kategorisë “profesor”;
- d) në kohën e kandidimit nuk rezulton të jetë rektor ose Drejtor i Shkollës së Magjistraturës;
- dh) rezulton se nuk ka masë disiplinore në fuqi;
- e) nuk është dënuar me vendim gjyqësor të formës së prerë për kryerjen e një vepre penale;
- ë) nuk ka mbajtur gjatë 10 viteve të fundit funksione politike në administratën publike ose pozicione drejtuese në partitë politike përpara kandidimit;
- f) nuk ka qenë anëtar, bashkëpunëtor ose i favorizuar i ish-Sigurimit të Shtetit para 2 korrikut 1991 në kuptimin e ligjit “Për të drejtën e informimit për dokumentet e ish-Sigurimit të Shtetit të Republikës Popullore Socialiste të Shqipërisë”;
- g) nuk rezulton të ketë qenë bashkëpunëtor, informator ose agjent i shërbimeve inteligjente;
- gj) në kohën e kandidimit, nuk rezulton të ketë asnjë anëtar të familjes, sipas kuptimit të ligjit “Për deklarimin dhe kontrollin e pasurive, të detyrimeve financiare të të zgjedhurve dhe të disa nëpunësve publikë”, si dhe të afërm të shkallës së parë që është kandidat për në Këshill.

Bazuar në verifikimin e parashtruar më sipër, kandidati Dariel Sina **nuk kualifikohet për këtë pozicion**, pasi gjendet në kushtet e mospërbushjes së kushtit ligjor të parashikuar nga neni 134, pika 2 germa “b” e ligjit nr. 115/2016.

2. Erjona Canaj

Nga shqyrtimi i dosjes së kandidates ka rezultuar se mungonte dokumentacioni si vijon:

- kopje e njësuar me origjinalin e pasaportës apo kartës së identitetit;
- dokumentacioni që vërteton jo më pak se 15 vjet përvojë profesionale si jurist;
- vërtetimi që në kohën e kandidimit ka jo më pak se 5 vjet në fakultetin e drejtësisë të një institucioni të arsimit të lartë;
- dëshmitë e titujve shkencorë të njësuar me origjinalin;
- vërtetim që nuk ka masë disiplinore në fuqi;
- dokumentacioni që vërteton se nuk është dënuar me vendim gjyqësor të formës së prerë për kryerjen e një vepre penale;
- vetëdeklarimi se në kohën e kandidimit nuk ka asnjë anëtar të familjes sipas kuptimit të ligjit "Për deklarimin dhe kontrollin e pasurive, të detyrimeve financiare të të zgjedhurve dhe të disa nëpunësve publikë" si dhe të afërm të shkallës së parë që është anëtar në detyrë i Këshillit ose kandidat për anëtar;
- formularët e mbështetjes së kandidaturës nga tre anëtarë të personelit akademik;
- dëshmia e gjuhës së huaj e njësuar me origjinalin;
- lista e notave e njësuar me origjinalin;
- diploma e përfundimit të studimeve të larta dhe njësimi përkatës nga ministria përgjegjëse për arsimin e noterizuar.

Në përgjigje të shkresës nr. 2014/30, datë 10.10.2017 të Sekretarit të Përgjithshëm, për plotësimin dhe dërgimin e dokumentacionit, kandidatja ka paraqitur dokumentet e kërkuara brenda afatit ligjor 5 ditor për plotësimin e dokumentacionit.

Në vazhdim të verifikimit të dokumentacionit të paraqitur, sipas kushteve ligjore të renditura në pikën 2, të nenit 134, të ligjit nr. 115/2016, rezulton se kandidatja Erjona Canaj:

a) është shtetase shqiptare;

b) nuk rezulton të ketë 15 vjet përvojë pune në profesion si juriste. Kandidatja është diplomuar në vitin 2005 në Universitetin "La Sapienza" Romë, fakt i cili vërtetohet edhe nga njësimi i diplomës së bërë nga Ministria e Arsimit dhe Shkencës;

c) në kohën e kandidimit, rezulton të jetë pedagoge me kohë të plotë në Fakultetin e Drejtësisë, Universiteti European i Tiranës, jo më pak se 5 vjet (prej vitit 2008);

ç) është personel akademik i kategorisë "lektor";

d) në kohën e kandidimit nuk rezulton të jetë rektor ose Drejtor i Shkollës së Magjistraturës;

dh) rezulton se nuk ka masë disiplinore në fuqi;

e) nuk është dënuar me vendim gjyqësor të formës së prerë për kryerjen e një vepre penale;

ë) nuk ka mbajtur gjatë 10 viteve të fundit funksione politike në administratën publike ose pozicione drejtuese në partitë politike përpara kandidimit;

f) nuk ka qenë anëtare, bashkëpunëtore ose e favorizuar e ish-Sigurimit të Shtetit para 2 korrikut 1991 në kuptimin e ligjit "Për të drejtën e informimit për dokumentet e ish-Sigurimit të Shtetit të Republikës Popullore Socialiste të Shqipërisë";

g) nuk rezulton të ketë qenë bashkëpunëtore, informatore ose agjente e shërbimeve inteligjente;

gj) në kohën e kandidimit, nuk rezulton të ketë asnjë anëtar të familjes, sipas kuptimit të ligjit "Për deklarimin dhe kontrollin e pasurive, të detyrimeve financiare të të zgjedhurve dhe të disa nëpunësve publikë", si dhe të afërm të shkallës së parë që është kandidat për në Këshill.

Bazuar në verifikimin e parashtruar më sipër, kandidatja **Eriona Canaj** nuk kualifikohet për këtë pozicion, pasi gjendet në kushtet e mospërbushjes së kushtit ligjor të parashikuar nga neni 134, pika 2 germa "b" e ligjit nr. 115/2016.

IV. VLERËSIMI I SHKALLËS SË PËRMBUSHJES SË KRITEREVE PROFESIONALE DHE MORALE SIPAS NENIT 132 TË LIGJIT NR. 115/2016 NGA KANDIDATËT QË PLOTËSOJNË KUSHTET LIGJORE

A. Verifikimi i kritereve profesionale dhe morale sipas nenit 132 të ligjit nr. 115/2016

Pas ezaurimit të verifikimit mbi kushtet ligjore të kandidatëve (pikat 2 -5 të nenit 35 të ligjit) Sekretari i Përgjithshëm konkludon se kualifikohen për të vijuar procedurat sipas ligjit 5 (pesë) kandidatë që plotësojnë kushtet ligjore nga 7 (shtatë) kandidatë që u përcollën nga Mbledhja e Posaçme e Drejtuesve të Institucioneve të Arsimit të Lartë dhe Shkollës së Magjistraturës.

Sekretari i Përgjithshëm në respektim të pikës 6 të nenit 35 zhvilloi më tej procesin e vlerësimit të shkallës së përmbushjes së kritereve profesionale dhe morale të parashikuara nga neni 132 i ligjit nr. 115/2016, për secilin nga kandidatët e kualifikuar që përmbushin kushtet ligjore.

Neni 132 i ligjit nr. 115/2016 parashikon në mënyrë të detajuar kriteret morale dhe profesionale mbi bazën e të cilave do të bëhet vlerësimi i kandidaturave për Këshillin e Lartë të Prokurorisë, si më poshtë:

Komisioni i Pavarur Ad Hoc bën renditjen e kandidatëve në bazë të meritave të tyre profesionale bazuar në:

a) rezultatet e vlerësimit profesional dhe të etikës të kandidatëve në punët që kanë bërë në të shkuarën, nëse ka, ose rezultatet e arritura gjatë përvojave të tyre të punës, që lidhen me ushtrimin e funksioneve në fushën përkatëse që lidhet me veprimtarinë e institucionit për të cilën kandidon;

b) vlerësimin e rëndësisë së punimeve akademike, studimeve shkencore, shkrimeve dhe ligjëratave profesionale, botimeve, si dhe pjesëmarrjen në aktivitete shkencore, pjesëmarrjen në procesin e hartimit ose të konsultimit të legjislacionit dhe çdo angazhim tjetër profesional të kandidatit përgjatë 5 viteve të fundit në fushën e së drejtës;

c) rezultatet gjatë studimeve në ciklet e arsimit të lartë;

ç) ecurinë në punë dhe pjesëmarrjen në trajnimet profesionale dhe në kurse të tjera të certifikuara brenda dhe jashtë vendit.

2. Komisioni bën renditjen e kandidatëve në bazë të meritave të tyre morale bazuar në:

a) reputacionin që gëzon kandidati në shoqëri dhe midis kolegëve;

b) cilësitë morale, të tilla si ndershmëria, përpikmëria në ushtrimin e detyrave, përgjegjshmëria, besueshmëria, paanësia, dinjiteti dhe prirja për të marrë përsipër përgjegjësi, etika profesionale, përdorimi i të gjitha mjeteve të ligjshme për mbrojtjen me besnikëri të të drejtave të personave që përfaqësohen prej tij;

c) angazhimin e provuar në ndjekje të kauzave të shoqërisë civile.

3. Komisioni bën renditjen e kandidatëve në bazë të meritave të tyre organizative, drejtuese dhe menaxheriale bazuar në:

a) cilësinë e platformës dhe të vizionit që paraqesin;

b) aftësitë e provuara për të marrë vendime dhe përgjegjësi bazuar në përvojat e mëparshme profesionale dhe shoqërore;

c) aftësitë e komunikimit;

ç) aftësitë e të punuarit në grup dhe në mjedise multidisiplinore ose multikulturore;

d) aftësitë e përfaqësimit në publik.

4. Krahas kriterëve të parashikuara në pikat 1, 2 dhe 3, të këtij neni, në vlerësimin e kandidatëve mbahen parasysh edhe:

a) mbajtja e titujve akademikë;

b) kryerja e studimeve dhe trajnimeve afatgjata jashtë vendit;

c) njohja e gjuhëve të huaja.

B. Vlerësimi sipas Mbledhjes së Posaçme

Në bazë të nenit 35, pika 7, germa “c” të ligjit nr. 115/2016, në raportin për vlerësimin e shkallës së përmbushjes së kriterëve profesionale dhe morale, Sekretari i Përgjithshëm mbështetet në procesin e zhvilluar, raportin si dhe dokumentacionin e përcjellë nga Mbledhja e Posaçme.

Në mbështetje të nenit 149, pika 8, të ligjit nr. 115/2016, Mbledhja e Posaçme harton një raport vlerësimi të shkallës së përmbushjes së kriterëve etike dhe profesionale të kandidatëve dhe bën renditjen e tyre. Vlerësimi i kriterëve etike dhe profesionale të kandidatëve bëhet duke zbatuar, për aq sa është e mundur dhe me ndryshimet e nevojshme, kërkesat e nenit 132 të këtij ligji.

Për këtë, Mbledhja e Posaçme gjykoj që vlerësimet për këto merita, bazuar në faktin që kandidatët vijnë nga e njëjta fushë veprimtare, janë përcjellë nëpërmjet vetë asambleve të personelit akademik të IAL-ve e të Këshillit Pedagogjik të Shkollës së Magjistraturës dhe vlejnë si referencë e fortë për vlerësimin moral të kandidatëve. Kjo pasi vetë këshillat pedagogjikë apo asambletë e personelit akademik janë në këtë rast edhe autoriteti i pajisur me të gjithë instrumentet e nevojshëm për të përcjellë këtë informacion, në funksion të procesit përzgjedhës, sipas ligjit nr. 115/2016.

Në përfundim të diskutimeve Mbledhja e Posaçme miratoi¹ me Vendimin nr.1 datë 20.9.2017, rregullat për vlerësimin e kriterëve profesionale dhe etike të kandidatëve për anëtarë të Këshillit të Lartë Gjyqësor dhe të Këshillit të Lartë të Prokurorisë nga trupa e pedagogëve. Në këtë vendim është bërë një ndarje prej katër nivele meritash, të ndara në komponentë, referuar, për aq sa është e mundur, nenit 132 të ligjit nr.115/2016, si më poshtë:

Në zbatim të nenit 149, pika 8 dhe nenit 132 të ligjit, në lidhje me renditjen për shkallën e pëmbushjes së kriterëve etike profesionale, Mbledhja e Posaçme miratoi një formular tip për vlerësimin objektiv të tyre si më poshtë:

1. **kriteri i meritave profesionale:** i vlerësuar me 30 pikë nga totali prej 100 pikë;
2. **kriteri i meritave morale:** i vlerësuar me 20 pikë nga totali prej 100 pikë;
3. **kriteri i meritave organizative, drejtuese, menaxheriale:** 30 nga 100 pikë;
4. **kritere i meritave të tjera,** 20 nga 100 pikë.

Totali i pikëve është 100.

Metodologjia: Secili nga anëtarët votues, gjatë shpalesjes së platformës së kandidatit dhe pyetjeve të drejtuara, bëri një vlerësim individual, anonim, i cili nuk mban emrin e anëtarit vlerësues. Anëtarët plotësuan formatin individual të vlerësimit për secilin kandidat, që iu dorëzua Sekretariatit Teknik të Kuvendit, i cili asistoi zhvillimin e Mbledhjes së Posaçme me dëgjuesat. Në fund çdo vlerësim u bë pjesë e vlerësimit përfundimtar, i cili u llogarit si një shumatorë pikësh e grumbulluar për secilin kandidat, duke nxjerrë një mesatare pas pjesëtimit të totalit të pikëve me numrin e anëtarëve të Mbledhjes së Posaçme.

¹Vendim nr. 1, datë 20.09.2017 "Për miratimin e rregullave për vlerësimin e kriterëve profesionale dhe morale të kandidatëve për anëtar të Këshillit të Lartë Gjyqësor dhe të Këshillit të Lartë të Prokurorisë nga trupa e pedagogëve".

Në përfundim të vlerësimit me pikë, sipas pikëve të marra në total, vlerësimi rezulton në këtë renditje:

Për kandidatët e përzgjedhur nga trupa e pedagogëve për në Këshillin e Lartë të Prokurorisë, morën pjesë në vlerësim 24 anëtarë të Mbledhjes së Posaçme. Në përfundim, nga të dhënat e hedhura në formatin individual të vlerësimit nga secili anëtar i Mbledhjes së Posaçme, referuar edhe nenit 149, pika 8 dhe nenit 132 të ligjit nr. 115/2016 “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”, rezultoi:

<i>Kandidati</i>	<i>Pikët Totale</i>
Gent Ibrahim	90.47 pikë
Mirela Bogdani	86.95 pikë
Sander Beçi	82 pikë
Dariel Sina	71.7 pikë
Erjona Canaj	68.2 pikë
Eneida Sema	66.95 pikë
Oriona Muçollari	56.2 pikë

C. Vlerësimi i ONM

Në bazë të parashikimeve të nenit 287 të ligjit nr. 115/2016, Operacioni Ndërkombëtar i Monitorimit (ONM) përcolli vlerësimin e tij. Referuar argumenteve të parashtruar në raportin e ONM-së rezulton se: “Me qëllim të sigurimit të një vlerësimi përmbledhës për secilin kandidat (të dhënë më poshtë sipas renditjes alfabetike) duke pasqyruar karakteristikat më të dukshme nga kriteret e theksuara në mënyrë të veçantë në nenin 132 të Ligjit, bazuar në materialin në dispozicion, paragrafët e vlerësimit që pasojnë përqendrohen në elementët që lidhen me:

- meritat profesionale (vlerësimi profesional dhe etika, vlerësimi i rëndësishëm së punimeve akademike/punës shkencore, rezultatet gjatë trajnimeve ligjore, pjesëmarrja në trajnimet profesionale);
- meritat morale (reputacioni në shoqëri/midis kolegëve dhe cilësitë morale);
- meritat organizative, drejtuese dhe menaxheriale (përmbajtja e platformës, aftësitë vendimmarrëse, aftësitë e komunikimit, aftësitë e përfaqësimit publik dhe aftësitë e të punuarit në grup);
- kriteret shtesë (titujt akademikë, studime/trajnime jashtë vendit dhe njohja e gjuhëve të huaja).

Sandër Beci

- Platforma e paraqitur nga kandidati konsiston vetëm nga një letër motivimi dhe një sërë parimesh dhe vlerash të përgjithshme.
- Jetëshkrimi tregon një rezultat mesatar shkencor /akademik.

Mirela Bogdani

- Platforma tregon dijeni të mirë për problemet që prekin gjyqësorin/ prokurorinë dhe sfidat me të cilat ballafaqohet KLP-ja, si dhe një qasje të mjaftueshme pragmatike.
- Jetëshkrimi tregon se kandidatja është përfshirë në mënyrë intensive në veprimtaritë e Shkollës së Magjistraturës.
- Për fat të keq nuk ishte e mundur nga jetëshkrimi i kandidatës të krijohet një pasqyrë e plotë e arritjeve të saj shkencore/akademike.

Erjona Canaj

- Platforma e kandidatës tregon angazhimin e saj personal, megjithëse mbetet e kufizuar në parime më shumë të përgjithshme, pa ndonjë vizion të veçantë dhe ndonjë drejtim në fushat e ndërhyrjes.
- Jetëshkrimi tregon një profil akademik shumë të mirë dhe dinamik.

Genti Ibrahimi

- Sipas jetëshkrimit të paraqitur nga kandidati, ka qenë i përfshirë në mësimdhënie në Shkollën e Magjistraturës vetëm në vitet 2016 dhe 2017, ndërsa nuk shihet veprimtari e tillë në periudhën kohore ndërmjet viteve 1998 dhe 2016. Kriteri i parashikuar në nenin 36 paragrafi 2 shkronja c) të ligjit 115/2016 (sipas të cilit "*kandidatët në kohën e kandidimit duhet të jenë pedagogë me kohë të plotë jo më pak se 5 vjet në fakultetin e drejtësisë të një institucioni të arsimit të lartë ose pedagogë të brendshëm ose të jashtëm jomagjistratë në Shkollën e Magjistraturës*") nuk duket se plotësohet nëse miratojmë interpretimin sipas të cilit veprimtaria pedagogjike me kohë të pjesshme duhet të ketë ndodhur secilin vit në pesë vjetët para kandidimit.
- Platforma e paraqitur nga kandidati konsiston nga një letër motivimi me një shprehje vlerash dhe aspiratash të përgjithshme.
- Nga jetëshkrimi është e paqartë nëse në vitet e fundit kandidati është angazhuar në veprimtari të rëndësishme shkencore / akademike.

Oriona Muçollari

- Platforma e paraqitur nga kandidatja përbëhet nga një letër motivimi, pa shprehjen e qartë të vizionit dhe të prioritetëve operacionale.
- Jetëshkrimi i kandidates është mesatar, pa angazhim të rëndësishëm shkencor / akademik në pesë vitet e fundit.

Eneida Sema

- Platforma e paraqitur nga kandidatja konsiston më shumë nga një letër motivuese dhe deklaratë parimesh dhe vlerash.
- Angazhimi akademik / shkencor duket të jetë mbi mesataren.

Darjel Sina

- Platforma tregon motivim por nuk paraqet ndonjë vizion specifik, me objektiva që duhen përmbushur.
- Jetëshkrimi tregon një dosje mesatare të punës akademike / shkencore.

- Jetëshkrimi tregon se gjatë periudhës 9/2013 deri 9/2014 kandidati nuk ka qenë profesor ose ligjërues me kohë të plotë (ka punuar si "hulumtues i lartë" për një universitet të huaj): kjo duket se nuk është në përputhje me kriterin e parashikuar në nenin 134 paragrafi 2 shkronja c) të Ligjit.

V. VLERËSIMI I SEKRETARIT TË PËRGJITHSHËM TË KUVENDIT

Sekretari i Përgjithshëm i Kuvendit hartoi vendimin nr.13, datë 25.10.2017, "*Për miratimin e rregullave për vlerësimin e kriterëve profesionale dhe morale të kandidatëve për anëtarë të KLGJ dhe KLP nga trupa e pedagogëve*". Në vendim është konceptuar një ndarje prej katër nivele meritash, të ndara në komponentë referuar nenit 132 të ligjit, si më poshtë:

Meritat profesionale: 4 komponentë që përfshijnë:

- i. rezultatet e vlerësimit profesional dhe të etikës të kandidatëve në punët që kanë bërë në të shkuarën, nëse ka, ose rezultatet e arritura gjatë përvojave të tyre të punës, që lidhen me ushtrimin e funksioneve në fushën përkatëse që lidhet me veprimtarinë e institucionit për të cilën kandidon;
- ii. vlerësimin e rëndësisë së punimeve akademike, studimeve shkencore, shkrimeve dhe ligjëratave profesionale, botimeve, si dhe pjesëmarrjen në aktivitete shkencore, pjesëmarrjen në procesin e hartimit ose të konsultimit të legjislacionit dhe çdo angazhim tjetër profesional të kandidatit përgjatë 5 viteve të fundit në fushën e së drejtës;
- iii. rezultatet gjatë studimeve në ciklet e arsimit të lartë;
- iv. ecurinë në punë dhe pjesëmarrjen në trajnimet profesionale dhe në kurse të tjera të certifikuara brenda dhe jashtë vendit.

Totali i pikëve për këtë komponent është 30 pikë.

Meritat morale: 3 komponentë që përfshijnë:

- i. reputacionin që gëzon kandidati në shoqëri dhe midis kolegëve;
- ii. cilësitë morale, të tilla si ndershmëria, përpikmëria në ushtrimin e detyrave, përgjegjshmëria, besueshmëria, paanësia, dinjteti dhe prirja për të marrë përsipër përgjegjësi, etika profesionale, përdorimi i të gjitha mjeteve të ligjshme për mbrojtjen me besnikëri të të drejtave të personave që përfaqësohen prej tij;
- iii. angazhimin e provuar në ndjekje të kauzave të shoqërisë civile.

Totali i pikëve për këtë komponent është 20 pikë.

Meritat organizative drejtuese dhe menaxheriale me 5 komponentë, që përfshijnë:

- i. cilësinë e platformës dhe vizionit që paraqesin;
- ii. aftësitë e provuara për të marrë vendime dhe përgjegjësi bazuar në përvojat e mëparshme profesionale dhe shoqërore;
- iii. aftësitë e komunikimit;
- iv. aftësitë e të punuarit në grup dhe në mjedise multidisiplinore ose multikulturore;
- v. aftësitë e përfaqësimit në publik.

Totali i pikëve për këtë komponent është 30 pikë.

Merita të tjera: 3 komponentë, që përfshijnë:

- i. mbajtjen e titujve akademikë;
- ii. kryerjen e studimeve dhe trajnimeve afatgjata jashtë vendit;
- iii. njohjen e gjuhëve të huaja.

Totali i pikëve për këtë komponent është 20 pikë.

Totali përfundimtar për të katër kategoritë e meritave që parashikon neni 132 i ligjit, është 100 pikë.

Konkluzionet e Sekretarit të Përgjithshëm

Bazuar në shqyrtimin e dokumentacionit tërësor të dosjeve individuale të kandidatëve, procesit dhe praktikës së Mbledhjes së Posaçme dhe raportin e vlerësimit të tij, duke marrë në konsideratë:

1. dokumentacionin individual të çdo kandidati, dokumentacionin plotësues dhe korrespondencën përkatëse;
2. mjetet procedurale në dispozicion të Mbledhjes së Posaçme, për të vlerësuar përmbushjen e kriterëve morale dhe profesionale nga kandidatët, intervistave me kandidatët si dhe përbërjen e Mbledhjes së Posaçme me përfaqësues nga dekanët, rektorët e IAL-ve të akredituara sipas legjislacionit në fuqi dhe të Drejtorit të Shkollës së Magjistraturës (neni 146 i ligjit);

3. parashikimet e nenit 35 të ligjit i cili i jep të drejtën Sekretarit të Përgjithshëm të kërkojë vetëm plotësimin e dokumentacionit që vërteton plotësimin e kushteve kushtetuese dhe ligjore pa zhvilluar seanca dëgjimore me kandidatët;
4. parashikimet e nenit 35 pika 6, që referojnë në nenin 132 të ligjit, për sa i takon kriteret profesionale dhe morale të kandidatëve dhe vendimin nr. 13, datë 25.10.2017 të Sekretarit të Përgjithshëm “Për miratimin e rregullave për vlerësimin e kriterëve profesionale dhe morale të kandidatëve për anëtarë të KLGJ dhe KLP nga trupa e pedagogëve”;

Sekretari i Përgjithshëm i Kuvendit jep vlerësimin e tij², në konsideratë të procesit të zhvilluar dhe raportin e përgatitur nga Mbledhja e Posaçme, kjo në respektim të nenit 35, pika 7, shkronja “c”, ku parashikohet se Sekretari i Përgjithshëm harton ndër të tjera: “një raport me shkrim ku vlerësohet shkalla e përmbushjes së kriterëve profesionale dhe morale nga secili kandidat, Sekretari i Përgjithshëm mbështetet në procesin e zhvilluar dhe raportin e Mbledhjes së Posaçme.”

- Për meritat profesionale dhe meritat e tjera bazuar në komponentët përkatës që përcakton neni 132 i ligjit, Sekretari i Përgjithshëm ka qenë në gjendje të kryejë vlerësimin e tij bazuar në dokumentacionin provues të dosjeve të çdo kandidati duke qenë se plotësimi i këtyre meritave ishte i matshëm.
- Gjithashtu për dy nënkomponentët: a) cilësinë e platformës dhe vizionit që paraqet kandidati si dhe d) për aftësitë e përfaqësimit në publik (pjesë të kategorisë së meritave organizative, drejtuese dhe menaxheriale), Sekretari i Përgjithshëm ka qenë në gjendje të kryejë vlerësimin e tij bazuar në intervistat me kandidatët të zhvilluara nga Mbledhja e Posaçme si dhe nga dokumentacioni i dosjeve të çdo kandidati, duke qenë se ky vlerësim meritash ishte i matshëm.
- Pikëzimi për këta nënkomponentë nga ana e Sekretarit të Përgjithshëm rezultoi i ndryshëm nga pikëzimi i Mbledhjes së Posaçme.
- Për nënkomponentët e tjerë të meritave organizative, drejtuese dhe menaxheriale, si dhe të meritave morale të përcaktuara në nenin 132, pika 2 dhe 3 të ligjit nr.115/2016, të cilat janë të vështira për t'u vlerësuar në bazë të dokumentacionit të paraqitur, Sekretari i Përgjithshëm duke pasur në konsideratë përbërjen e Mbledhjes së Posaçme, me

² Në raportin e ONM argumentohet se SPK-ja dhe ONM-ja nuk lidhen me vlerësimin e bërë nga Mbledhja e Posaçme. Prandaj, mund të supozohet se, nëse është relevante, ata mund ta zëvendësojnë dhe/ose ta integrojnë rezultatin e vlerësimit të arritur në Mbledhjen e Posaçme.

përfaqësues nga trupa pedagogjike, gjykoj se vlerësimet për këto merita, bazuar në faktin që kandidatët vijnë nga e njëjta fushë veprimtarie, janë përcjellë nëpërmjet këtyre anëtarëve, por edhe nëpërmjet mbledhjes të asambleve të personelit akademik të fakulteteve të drejtësisë dhe Këshillit Pedagogjik të Shkollës së Magjistraturës.

Pavarësisht kësaj, Sekretari i Përgjithshëm ka bërë vlerësim për disa nga nënkomponentët e meritave morale nisur nga përfshirja dhe ekspertiza e ofruar nga disa prej kandidatëve, në procesin e Reformës në Drejtësi dhe draftimin e ligjeve si pjesë e Paketës së kësaj Reforme.

Gjithsesi Mbledhja e Posaçme mbetet organi i pajisur me të gjithë instrumentet e nevojshëm për të përcjellë informacion për çdo kandidat, në funksion të procesit përzgjedhës, sipas ligjit nr. 115/2016 duke përbërë një vlerë të shtuar në garancitë që ofrohen për të pasur një proces real të përzgjedhjes.

Gjithashtu Sekretari i Përgjithshëm ka konstatuar se nga praktika e përcjellë nga Mbledhja e Posaçme rezultoi se në tërësi nuk ka informacion për mënyrën e dhënies së pikëve për çdo nënkomponent të meritave profesionale, meritave morale, meritave organizative, drejtuese dhe menaxheriale dhe meritave të tjera për secilin kandidat, për të pasur një informacion të plotë veçanërisht në lidhje me nënkomponentët e këtyre meritave. Si dokument për arsyetimin e mënyrës së pikëzimit të vendosur nga Mbledhja e Posaçme, është paraqitur procesverbali i Mbledhjes së Posaçme.

Sekretari i Përgjithshëm i Kuvendit në respektim të parashikimeve vlerësoi se:

Kandidati Sandër Beci:

Për sa i takon nivelit të studimeve akademike rezultoi se kandidati ka përfunduar ciklin 4-vjeçar të studimeve të larta në Fakultetin e Drejtësisë së Universitetit të Shkodrës me rezultate të larta. Kandidati ka kryer studimet pasuniversitare të ciklit të dytë master dhe ka fituar titullin shkencor “Doktor i shkencave”.

Platforma e paraqitur nga kandidati paraqet një përmbledhje të problematikave të deritanishme të institucionit të prokurorisë si dhe pasqyron një listë objektivash dhe qëllimesh që kandidati propozon të realizojë në rast zgjedhje si anëtar i KLP-së.

Kandidati ka mbrojtur gjuhën angleze me rezultate të larta. Referuar CV-së, rezulton se eksperiencia e kandidatit është fokusuar vetëm në botën akademike. Në këtë drejtim kandidati ka publikuar botime shkencore si dhe ka marrë pjesë në një numër të konsiderueshëm konferencash shkencore kombëtare dhe ndërkombëtare.

- Për meritat profesionale, Sekretari i Përgjithshëm vlerëson se kandidati duhet të vlerësohet me 21,4 pikë nga 30 maksimumi.
Ky pikëzim është i ndryshëm nga pikëzimi i Mbledhjes së Posaçme (i vlerësuar me 23,4/30 pikë maksimumi), për shkak të moskryerjes së veprimtarive dhe përvojave profesionale të lidhura me ushtrimin e fushës përkatëse ku kandidon.
- Për meritat organizative, drejtuese dhe menaxheriale Sekretari i Përgjithshëm vlerëson se kandidati duhet të vlerësohet me 21,3 pikë nga 30 pikë maksimumi. Ky pikëzim është i ndryshëm nga ai i Mbledhjes së Posaçme (i vlerësuar me 23,3/30 pikë maksimumi) për shkak të cilësisë së platformës.
- Për meritat e tjera (komponenti i kryerjes së specializimeve afatgjata jashtë vendit) kandidati u vlerësua me 16,1 pikë/20 maksimumi). Ky pikëzim është i ndryshëm nga pikëzimi për këtë kategori merite që ka vlerësuar Mbledhja e Posaçme (17,1/20 pikë maksimumi) për shkak se referuar CV-së nuk rezulton që kandidati të ketë kryer studime afatgjata jashtë vendit.

Në total kandidati vlerësohet me **77 pikë**.

Kandidatja Encida Sema:

Për sa i takon nivelit të studimeve akademike rezulton se kandidatja ka përfunduar ciklin 4-vjeçar të studimeve të larta në Fakultetin e Drejtësisë së Universitetit të Tiranës me rezultate të larta. Kandidatja ka kryer studimet pasuniversitare të ciklit të dytë master dhe ka fituar titullin shkencor “Doktor i shkencave” dhe “Profesor i asociuar”.

Kandidatja ka paraqitur një platformë të përgjithshme duke u fokusuar më tepër në funksionet e institucionit të KLP-së sesa në parashtrimin e objektivave që kandidatja kërkon të përmbushë si anëtare e mundshme e KLP-së.

Kandidatja ka mbrojtur gjuhën angleze me rezultate të larta. Referuar CV-së rezulton kandidatja ka qenë pjesëmarrëse në një numër të konsiderueshëm konferencash shkencore kombëtare dhe ndërkombëtare si dhe ka një eksperiencë të konsiderueshme në botimin e artikujve në revista shkencore.

Gjatë intervistës kandidatja iu përgjigj mjaftueshërisht pyetjeve të parashtruar, gjithsesi duhet të tregonte më tepër informacion në çështje të lidhura me fushën në të cilën aplikon.

- Për merita profesionale Sekretari i Përgjithshëm vlerëson se kandidatja duhet të vlerësohet me 19.2 pikë. Ky pikëzim është i ndryshëm nga ai i Mbledhjes së Posaçme (i vlerësuar me 20,2/30 pikë maksimumi) për shkak të moskryerjes së veprimtarive dhe përvojave profesionale të lidhura me ushtrimin e fushës përkatëse ku kandidon.
- Për meritat organizative, drejtuese dhe menaxheriale Sekretari i Përgjithshëm vlerëson se kandidatja duhet të vlerësohet me 15.2 pikë nga 30 pikë maksimumi. Ky pikëzim është i ndryshëm nga ai i Mbledhjes së Posaçme (i vlerësuar me 18.2/30 pikë maksimumi) për shkak të cilësisë së platformës dhe aftësive të përfaqësimit në publik.
- Për meritat e tjera (komponenti për mbajtjen e titujve akademikë) kandidati u vlerësua me 15.1 pikë/20 maksimumi. Ky pikëzim është i ndryshëm nga pikëzimi për këtë kategori merite që ka vlerësuar Mbledhja e Posaçme (12.1/20 pikë maksimumi) për shkak se kandidatja ka fituar gradën shkencore “profesor i asociuar”.

Në total kandidatja vlerësohet me **65.95 pikë**.

Kandidatja Mirela Bogdani

Për sa i takon nivelit të studimeve akademike rezulton se kandidatja ka përfunduar ciklin 4-vjeçar të studimeve të larta në Fakultetin e Drejtësisë së Universitetit të Tiranës me rezultate shumë të larta. Kandidatja ka kryer studimet pasuniversitare të ciklit të dytë master si dhe ka fituar titullin shkencor “Doktor i shkencave” dhe “Profesor i asociuar” akorduar nga Universiteti i Tiranës.

Platforma personale tregon një vizion të qartë të kandidates për detyrat dhe rolin që do të luajë si anëtare e mundshme e KLP-së.

Gjatë intervistës kandidatja iu është përgjigjur me korrektësi të gjitha pyetjeve duke treguar profesionalizëm dhe njohuri për fushën në të cilën aplikon.

Kandidatja ka mbrojtur gjuhën angleze me rezultate të larta.

Referuar CV-së, rezulton se kandidatja përveç jetës akademike, ka një eksperiencë shumë të pasur të botimeve në revistat shkencore kombëtare dhe ndërkombëtare si dhe ka qenë pjesëmarrëse në një numër relativisht të lartë konferencash ndërkombëtare.

- Për merita profesionale Sekretari i Përgjithshëm vlerëson se kandidatja duhet të vlerësohet me 24 pikë. Ky pikëzim është i ndryshëm nga ai i Mbledhjes së Posaçme (e vlerësuar me 26/30 pikë maksimumi) për shkak të mospasjes së eksperiencës në veprimtaritë e lidhura me institucionin ku kandidon.

Në total kandidatja vlerësohet me 85.95 pikë.

Kandidati Gent Ibrahimi

Kandidati është diplomuar nga Fakulteti i Drejtësisë së Universitetit të Tiranës me rezultate të shkëlqyera. Rezultatet e arritura gjatë punës së kandidatit në sektorin privat, siç rezultojnë nga jetëshkrimi i tij, janë shumë të mira.

Kandidati ka një përvojë të gjatë profesionale, në sektorin privat si drejtues i një organizate joqeveritare dhe ekspert për organizatat ndërkombëtare. Njëkohësisht ai është angazhuar si ekspert ndërkombëtar në shumë projekte me impakt në fushën e drejtësisë.

Rezulton se nga jetëshkrimi është angazhuar në projekte të lidhura me institucionet e drejtësisë (projekti i Këshillit të Europës për luftën kundër korrupsionit (PACA) që lidhen në të ardhmen e afërt me veprimtarinë e parashikuar nga ligji për institucionin në të cilin kandidon (KLP).

Rezulton e dokumentuar se kandidati ka kryer punime, studime shkencore dhe veçanërisht botime, si autor dhe bashkautor, të cilat kanë gjetur pasqyrim edhe në programet mësimore të disa lëndëve të së drejtës në fakultetet e drejtësisë. Sa i përket eksperiencës së kandidatit në hartimin e ligjeve, sipas dokumentacionit të administruar në dosje rezulton përfshirja e tij, në hartimin e Kushtetutës së vitit 1998 dhe si ekspert i nivelit të lartë të Komisionit të Posaçëm të Reformës në Drejtësi (bashkëkryetar i grupit të punës për gjyqësorin) për hartimin e amendamenteve kushtetuese të vitit 2016 dhe të legjislacionit pasues.

Në paraqitjen e platformës me shkrim por edhe nga seancën dëgjimore të Mbledhjes së Posaçme del në pah vizioni i kandidatit dhe objektivat shumë të qarta për detyrat e pozicionit ku kandidon.

- Për merita profesionale Sekretari i Përgjithshëm vlerëson se kandidati duhet të vlerësohet me 30 pikë. Ky pikëzim është i ndryshëm nga ai i Mbledhjes së Posaçme (i vlerësuar me 27.7/30 pikë maksimumi) për shkak të ekspertizës së pikasur që ka ofruar në fusha specifike që lidhen me pozicionin ku aplikon dhe për shkak të angazhimit si ekspert i nivelit të lartë në reformën në drejtësi.
- Për meritat morale Sekretari i Përgjithshëm vlerëson se kandidati duhet të vlerësohet me 20 pikë, ku përgjatë angazhimit të tij intensiv në 3 vitet e fundit në procesin e reformës dhe me konsultimet e hartimit të legjislacionit pranë Kuvendit të Shqipërisë, është konstatuar se kandidati gëzon besueshmëri, përpikmëri dhe përgjegjshmëri maksimale në kontributin e dhënë Kuvendit.

Në total kandidati vlerësohet me **94,17 pikë**.

Kandidatja Oriona Muçollari:

Për sa i takon nivelit të studimeve akademike rezulton se kandidatja ka përfunduar ciklin 4-vjeçar të studimeve të larta në Fakultetin e Drejtësisë së Universitetit të Tiranës me rezultate të mira. Kandidatja ka fituar titullin shkencor “Doktor i shkencave” dhe “Profesor i asociuar” akorduar nga Universiteti i Tiranës.

Referuar CV-së, rezulton se kandidatja ka qenë pjesë e disa grupeve të punës për hartimin e legjislacionit në fushën e arsimit, ka disa botime në revista shkencore si dhe ka marrë pjesë në trajnime profesionale dhe aktivitete të tjera brenda dhe jashtë vendit. Platforma personale që ka paraqitur kandidatja është një dokument që nuk jep shumë mundësi për të vlerësuar pritshmëritë dhe vizionin e kandidates për funksionimin e KLP-së dhe anëtarësimin në këtë organ.

Kandidatja nuk është paraqitur në seancën dëgjimore të zhvilluar në Mbledhjen e Posaçme, pasi ndodhej jashtë shtetit.

- Për meritat organizative, drejtuese dhe menaxheriale Sekretari i Përgjithshëm vlerëson se kandidatja duhet të vlerësohet me 13.6 pikë nga 30 pikë maksimumi. Ky pikëzim është i ndryshëm nga ai i Mbledhjes së Posaçme (e vlerësuar me 15.6/30 pikë maksimumi) për shkak të cilësisë së platformës si dhe për shkak të mosprezencës në seancën dëgjimore.
- Për meritat e tjera (komponenti për mbajtjen e titujve akademikë) kandidatja vlerësohet me 14.7 pikë/20 maksimumi. Ky pikëzim është i ndryshëm nga pikëzimi për këtë kategori merite që ka vlerësuar Mbledhja e Posaçme (11.7/20 pikë maksimumi), për shkak se kandidatja ka fituar gradën shkencore “Profesor i asociuar”.

Në total kandidatja vlerësohet me **57.2 pikë**.

Në përfundim, Sekretari i Përgjithshëm bazuar në:

- argumentimin e mësipërm;
- vendimin nr.13, datë 25.10.2017 të Sekretarit të Përgjithshëm për pikëzimin e kritereve;
- vlerësimin e detajuar me pikë të përmbushjes së kritereve profesionale dhe morale nga kandidatët të kryer nga Mbledhja e Posaçme;
- nenin 35 pika 7 germa “c” sipas të cilit Sekretari i Përgjithshëm vlerëson shkallën e përmbushjes së kritereve profesionale dhe morale nga secili kandidat;
- dokumentacionin e dosjeve individuale të kandidatëve;

Konkludon se renditja e kandidatëve sipas shkallës së plotësimit të kriterëve është si më poshtë:

Nr.	Kandidati (Emër Mbiemër)	Pikët Totale sipas SP
1.	Gent Ibrahim	94.17 pikë
2.	Mirela Bogdani	85.95 pikë
3.	Sandër Beci	77 pikë
4.	Eneida Sema	65.95 pikë
5.	Oriona Muçollari	57.2 pikë
6.	Erjona Canaj	nuk kualifikohet
7.	Dariel Sina	nuk kualifikohet

VI. PËRCJELLJA E VLERËSIMIT NGA OPERACIONI NDËRKOMBËTAR I MONITORIMIT

Në bazë të nenit 287 pika 3 të ligjit nr. 115/2016, Operacioni Ndërkombëtar i Monitorimit përcolli vlerësimin e kandidatëve për t'u përzgjedhur nga përfaqësuesit e pedagogëve për Këshillin e Lartë të Prokurorisë, në datën 25.10.2017. Në bazë të pikës 4 të po këtij neni, Sekretari i Përgjithshëm reflekton vlerësimin e përcjellë nga ONM në listat e kandidatëve që plotësojnë kushtet përcaktuara në Kushtetutë dhe ligj dhe të kandidatëve të përjashtuar (listat sipas shkronjave "a" dhe "b" të pikës 7 të nenit 35 të ligjit) që i përcjell Komisionit të përhershëm përgjegjës për çështjet ligjore në Kuvend.

Në raportin e tij Sekretari i Përgjithshëm ka marrë në konsideratë për aq sa është e mundur vlerësimin e ONM-së në vlerësimin me pikë që i është bërë kandidatëve për shkallën e

përbushjes së kriterëve profesionale dhe morale. Ndërkohë, lista kandidatëve që plotësojnë kushtet kushtetuese dhe ligjore sipas vlerësimit të Sekretarit të Përgjithshëm është e ndryshme nga lista e kandidatëve që rezulton nga raporti i ONM-së, kjo pasi:

Për kandidatin Darjel Sina, ONM është shprehur se jetëshkrimi tregon se gjatë periudhës 9/2013 deri 9/2014 kandidati nuk ka qenë profesor ose ligjërues me kohë të plotë, duke mos plotësuar afatin prej 5 vitesh si pedagog i brendshëm ose i jashtëm në përputhje me kriterin e parashikuar në nenin 36 paragrafi 2 shkronja c) të ligjit. Nga dokumentacioni i dosjes personale, konkretisht librezja e punës, rezulton se kandidati ka filluar marrëdhënien e punës si pedagog i brendshëm në Universitetin Evropian të Tiranës nga data 1.10.2009 deri në 31.08.2013 dhe pedagog i brendshëm/dekan i Fakultetit të Drejtësisë në Universitetin "Luarasi", nga data 6.10.2014 deri në 6.10.2015. Prej datës 30.10.2015 kandidati është pedagog dhe Drejtor i Departamentit të Drejtësisë në Universitetin e New York, Tiranë.

Ndërkohë kandidati nuk kualifikohet, sipas vlerësimit të Sekretarit të Përgjithshëm, për shkak të mosplotësimit të kushtit ligjor të parashikuar nga neni 134, pika 2, shkronja "b" të ligjit, pasi nuk ka 15 vite përvojë pune si jurist, duke qenë i diplomuar në vitin 2004.

Për sa i përket kriterit të parashikuar nga shkronja "c", e pikës 2, të nenit 134 të ligjit nr. 115/2016, Sekretari i Përgjithshëm konstaton dhe vlerëson se ky kriter përmbushet nga kandidati.

Për kandidatin Gent Ibrahimi, ONM është shprehur se sipas jetëshkrimit të paraqitur nga kandidati, ky i fundit ka qenë i përfshirë në mësimdhënie në Shkollën e Magjistraturës vetëm në vitet 2016 dhe 2017, ndërsa nuk shihet veprimtari e tillë në periudhën kohore ndërmjet viteve 1998 dhe 2016. Kriteri i parashikuar me nenin 134 paragrafi 2 shkronja c) të ligjit nr. 115/2016 (sipas të cilit "*kandidatët në kohën e kandidimit duhet të jenë pedagogë me kohë të plotë jo më pak se 5 vjet në fakultetin e drejtësisë të një institucioni të arsimit të lartë ose pedagogë të brendshëm ose të jashtëm jomagjistratë në Shkollën e Magjistraturës*") nuk duket se plotësohet nëse miratojmë interpretimin sipas të cilit veprimtaria pedagogjike me kohë të pjesshme duhet të ketë ndodhur secilin vit në pesë vjetët para kandidimit.

Nga dokumentacioni i dosjes personale, konkretisht vërtetimi i lëshuar nga Shkolla e Magjistraturës me nr. 547 Prot, datë 19.07.2017, rezulton se kandidati është pjesë e stafit pedagogjik të Shkollës së Magjistraturës që prej vitit 2003 dhe në vijimësi, si dhe është angazhuar si trajner në Programin e Formimit Vazhdues. Aktualisht është pedagog i jashtëm në Programin e Formimit Fillestar në lëndën e Etikës Profesionale..

Për rrjedhojë Sekretari i Përgjithshëm vlerëson se kandidati Gent Ibrahimi përmbush kushtin e parashikuar nga neni 134 pika 2 germa "c" ligjit 115/2016,

VII. PËRFUNDIME

Në përfundim të këtij procesi vlerësimi, Sekretari i Përgjithshëm i Kuvendit, bazuar në pikën 9 të nenit 35, si dhe në pikën 4 të nenit 287 të ligjit, i përcjell Komisionit të përhershëm përgjegjës për çështjet ligjore në Kuvend këtë raport, listën e kandidatëve që plotësojnë kushtet kushtetuese dhe ligjore, listën e kandidatëve të përjashtuar, si dhe kopjen e raportit të Operacionit Ndërkombëtar të Monitorimit, së bashku me dokumentacionin për secilin kandidat.

Bashkëlidhur këtij raporti gjenden lista e kandidatëve që plotësojnë kushtet kushtetuese dhe ligjore si dhe lista e kandidatëve të përjashtuar.

Në respekt të përcaktimit ligjor të nenit 35, pika 9 të ligjit nr.115/2016, listat dhe raporti i Sekretarit të Përgjithshëm të Kuvendit, do të bëhen menjëherë publike në faqen zyrtare të Kuvendit.

SEKRETARI I PËRGJITHSHËM




Lista e kandidatëve për anëtarë të Këshillit të Lartë të Prokurorisë nga trupa e pedagogëve, që nuk plotësojnë kushtet ligjore të parashikuara nga Kushtetuta dhe neni 134, pika 2, i ligjit 115/2016 “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”, sipas vlerësimit të bërë nga Sekretari i Përgjithshëm i Kuvendit, bazuar në nenin 35, pika 7, shkronja “b” të ligjit 115/2016

(sipas rendit alfabetik të emrit)

1. Darjel Sina
2. Erjona Canaj

(Universiteti i New York Tirana)
(Universiteti Evropian i Tiranës)



Lista e kandidatëve për anëtarë të Këshillit të Lartë të Prokurorisë nga trupa e pedagogëve, që plotësojnë kushtet ligjore të parashikuara nga Kushtetuta dhe neni 134, pika 2, i ligjit 115/2016 “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”, sipas vlerësimit të bërë nga Sekretari i Përgjithshëm i Kuvendit, bazuar në nenin 35, pika 7, shkronja “a” të ligjit 115/2016

(sipas rendit alfabetik të emrit)

- | | |
|---------------------|--|
| 1. Eneida Sema | <i>(Universiteti i Tiranës)</i> |
| 2. Gent Ibrahim | <i>(Shkolla e Magjistraturës)</i> |
| 3. Mirela Bogdani | <i>(Universiteti i Tiranës)</i> |
| 4. Oriona Muçollari | <i>(Universiteti i Tiranës)</i> |
| 5. Sandër Beci | <i>(Universiteti “Luigj Gurakuqi” Shkodër)</i> |

